



SENATI AKADEMIK

Nr. 157 Prot

Tiranë, më 02.02.2022

VENDIM

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Statuti dhe Rregulloren e Brendshme të Universitetit “Metropolitan Tirana”, Senati Akademik:

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores së këshillit studentor
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Senatit Akademik

Rektori

Prof. Dr. Nikolla CIVICI





UNIVERSITETI[®]
METROPOLITAN
TIRANA

RREGULLORE E KËSHILLIT STUDENTOR

MIRATUAR ME VENDIM TË SENATIT AKADEMIK

NR. 157, DATË 02.02.2022



Tiranë, 2022

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave që lidhen me funksionimin dhe organizimin e Këshillit Studentor të Universitetit “Metropolitan Tirana”, i cili është një organizim i pavarur i studentëve dhe që funksionon si pjesë përbërëse e këtij universiteti. Rregullorja bazohet në nenin 54 dhe 55 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Statutin e Universitetit “Metropolitan Tirana”.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e përdorur në përmbajtje kanë kuptimin si më poshtë:

“**KSUMT**” është Këshilli Studentor i Universitetit “Metropolitan Tirana”;

“**SS**” është Senati Studentor;

“**KZ**” është Komisioni Zgjedhor;

“**UMT**” është Universiteti “Metropolitan Tirana”;

“**Senator**” quhet studenti i zgjedhur nga trupa zgjedhore e studentëve për të përfaqësuar degën e një viti në “KSUMT” dhe para organeve vendimmarrëse të secilit Fakultet dhe Universitetit;

“**Zonë elektorale**” është dega e studimit që përfaqësohet në senat me një senator për çdo vit.

“**Kuorum**” quhet prania e 50% +1 e të gjithë anëtarëve të organit përkatës. Për plotësimin e “Kuorum”-it në rastin e mbledhjeve të “SS” nuk llogaritet numri i senatorëve të viteve të fundit.

NENI 3

Objektivat e “KSUMT”

Këshilli Studentor i Universitetit “Metropolitan Tirana” ka për qëllim:

- Të kontribuojë në rritjen e aftësive organizuese dhe administruese të grupeve më aktive të studentëve;
- Të krijojë struktura që shërbejnë për informimin e studentëve dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e tyre;
- Të bashkëpunojë me organet drejtuese të Universitetit me synim përmirësimin e nivelit mësimor dhe kërkimor-shkencor;
- Të krijojë e përforcojë lidhjet midis studentëve të Universitetit dhe studentëve të universiteteve të tjera në Shqipëri dhe nëpër botë;
- Të ndër marrë veprime që do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes së studentëve;
- Të krijojë struktura ndihmëse në zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore për studentët;
- Të trajtojë shqetësimet e studentëve dhe të veprojë për zgjidhjen e tyre;
- Të ofrojë shërbime lehtësuese për studentët;
- Të zhvillojë nivelin kulturor dhe arsimor të studentëve;
- Të kryejë aktivitete kulturore, artistike, sportive etj., që synojnë argëtimin e studentëve në mënyrë të larmishme.

Neni 4

Zgjedhjet Studentore

1. Zgjedhjet studentore për përzgjedhjen e anëtarëve të rinjë të “KSUMT”, të cilëve u ka mbaruar mandati caktohen në mbledhjen e Rektoratit, duke marrë parasysh afatet e nevojshme për krijimin e komisioneve përkatëse dhe zhvillimin e fushatës zgjedhore. Periudha zgjedhore dhe datat shpallen me vendim të Rektorit të “UMT”-së.
2. Me nisjen e këtij procesi, vihen në dijeni autoritetet drejtuese të “UMT”-së. Votimi për Senatin Studentor do të kryhet përmes platformës Edu4School.

KREU II

ORGANIZIMI I “KSUMT”

Neni 5

Vula e Këshillit Studentor

Vula e “KSUMT” është në formë rrethore dhe në mes ndodhet logo e saj, e cila është e njëjtë me logon e “UMT”-së, por në pjesën e poshtme shkruhet: “Këshilli Studentor”.

Neni 6

Pavarësia Politike

“KSUMT” është një organizëm jo politik, të cilit i ndalohet çdo lloj bashkëpunimi me parti dhe organizata politike brenda dhe jashtë vendit. Duke qenë një organizëm i pavarur, ndalon në mënyrë eksplicite përfshirjen përfaqësuesëve të saj si: Senatorë, Kryetar/Zv.Kryetar, Sekretar i Përgjithshëm, Anëtarë të komisioneve që ngrihen nga “SS”, Anëtarë të grupeve të punës që ngrihen nga strukturat e “KSUMT” nga çdo prononcim politik publik, në emër të Këshillit Studentor të Universitetit “Metropolitan Tirana” apo strukturave të tij.

Neni 7

Organet Drejtuese

“KSUMT” ka në strukturën e tij organet drejtuese në bazë të së cilës organizohet dhe vepron, i përbërë nga :

- Senati Studentor “SS”;
- Bordi Ekzekutiv (Kryetari, zv/kryetari, sekretari i përgjithshëm dhe përgjegjësat e departamenteve përkatëse).

Neni 8

Senati Studentor

1. “SS” është organi kolegjal dhe vendimmarrës më i lartë i “KSUMT”, i cili ka këto kompetenca:
 - a) zgjedh ose shkarkon kryetarin me votim të fshehtë;
 - b) shkarkon senatorin me votim të fshehtë;
 - c) mandaton kryetarin;
 - d) krijon komisione të përhershme ose të përkohshme për çështje të ndryshme dhe përcakton mënyrën e funksionimit të tyre;
 - e) vendos për krijimin e marrëdhënieve me klubet studentore me synim bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë;
 - f) shpall datën e fillimit të fushatës elektorale brenda afatit të përcaktuar sipas nenit 4 pika 1;
 - g) shpall datën e zgjedhjeve të përgjithshme brenda afatit të përcaktuar sipas nenit 4 pika 1;
 - h) merr në shqyrtim dhe vendos për propozimet që bëhen nga organizma dhe organizata të ndryshme me qëllim bashkëpunimi e ndihmë të ndërsjellë;
 - i) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të “KSUMT”;

- j) miraton planin e aktiviteteve dhe buxhetin, dhe ja propozon atë Dekanit të Studentëve brenda muajit nëntor të atij viti akademik. Pas dakordësimit, Dekani i studentëve dërgon për miratim buxhetin tek Bordi i Administrimit;
- k) diskuton çdo gjë të jashtëzakonshme që vihet në rendin e ditës të mbledhjes dhe merr vendime rreth saj.
1. Anëtarët e "SS" quhen senatorë dhe zgjidhen çdo vit akademik nga komuniteti studentor i fakulteteve të "UMT". Ky organ mblidhet një herë në dy javë.
 2. Mbledhjet e "SS" janë të vlefshme kur në to janë njoftuar publikisht të gjithë senatorët, pavarësisht nga numri i pjesëmarrësve në mbledhje. Mbledhjet e saj drejtohen nga Kryetari i "KSUMT".
 3. Përveç rasteve kur statuti parashikon ndryshe, vendimet e "SS" merren me shumicën e thjeshtë të votave të senatorëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta vota e Kryetarit të "KSUMT" konsiderohet vendimtare në marrjen e vendimeve.
 4. Vendimi për shkarkimin e Kryetarit merret me votim të fshehtë, me 3/5 e votave të të gjithë senatorëve.
 5. Vendimet e "SS" hyjnë në fuqi menjëherë pasi firmosen dhe vulosen nga Kryetari;

Neni 9

Kryetari i "KSUMT"

1. Kryetari është senator i "KSUMT", i cili zgjidhet një herë në vit. Ai i ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen dhe mandatimin e kryetarit të ri.
2. Kryetari i "KSUMT" ka kompetenca si më poshtë:
 - a) drejton veprimtarinë e "KSUMT" në bazë të Rregullores;
 - b) hynë në marrëdhënie me organizma, organizata apo institucione të tjera pas vendimit të marrë nga "SS";
 - c) përgatit, thërret dhe drejton "SS" si në rastet e mbledhjeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme;
 - d) përcakton rendin e ditës së mbledhjes së "SS";
 - e) kujdeset për interesat e "KSUMT" si dhe përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët;
 - f) delegon në rast mungese të arsyetuar deri në një muaj kompetencat e tij tek zv/kryetari (në rast mungese të pajutifikueshme përtej afatit një mujor "SS" zgjedh Kryetarin e ri);

- g) nënshkruan dhe vulos për hyrjen në fuqi të vendimeve të “KSUMT”;
- h) përgatit projekt programin vjetor të aktiviteteve dhe e paraqet për miratim tek “SS”;
- i) merr në shqyrtim propozimet që bëhen nga institucione dhe organizata të ndryshme me qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë dhe i paraqet ato para “SS” dhe Dekanit të Studentëve;
- j) koordinon dhe zbaton vendimet e marra nga “KSUMT”;
- k) në bashkëpunim me organet e Universitetit nxit transparencën e shpenzimeve (financimet nga buxheti i universitetit dhe donacionet nëse ka);
- l) kryen çdo detyrë tjetër që është në përputhje me këtë rregullore dhe statutin e “UMT”-së.

Neni 10

Zv. Kryetari i “KSUMT”

1. “KSUMT” ka në përbërjen e tij tre zv/kryetarë, një për çdo fakultet të Universitetit.
2. Çdo zv/kryetar i “KSUMT” zgjidhet nga “SS” sipas fakulteteve përkatëse.
3. Çdo zv/kryetar i “KSUMT” ka një mandat një vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen dhe mandatimin e zv/kryetarit të ri;
4. Kompetencat e zv/kryetarit janë si më poshtë:
 - a) drejton mbledhjen e “SS” në rast mungese të kryetarit;
 - b) ushtron kompetencat e deleguara nga kryetari vetëm me deklaram të shkruar të këtij të fundit;
5. Mandati i zv/kryetarit mbaron edhe në rastet kur ai humbet mandatin e tij si senator.

Neni 11

Sekretari i Përgjithshëm i “KSUMT”

1. Sekretari i Përgjithshëm i “KSUMT” propozohet nga Kryetari dhe miratohet nga “SS”.
2. Çdo student i “UMT”-së mund të propozohet nga Kryetari për postin e Sekretarit të Përgjithshëm me të drejtë vote. Në rastin kur Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet nga studentët të cilët nuk janë senator, atëherë ai nuk ka të drejtë vote.
3. Mandati i Sekretarit është 1 (një) vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij deri në zgjedhjen dhe mandatimin e Sekretarit të ri.
4. Sekretari i Përgjithshëm ka kompetencat si më poshtë:

- a) njofton publikisht senatorët për mbledhjet e “KSUMT” dhe aktiviteteve të tjera të organizuara prej saj;
- b) mban protokollin për gjithë korrespondencën e “KSUMT” me organizma dhe institucione të tjerë.

Neni 12

Senatori i “KSUMT”

1. Senatori i “KSUMT” zgjidhet çdo vit akademik nga zona e tij elektorale. Çdo kandidat për Senator duhet të ketë mesataren e ponderuar 7.5 e sipër.
2. Senatori ka të drejtën të kandidojë për çdo funksion në “KSUMT”, përfshirë edhe postin e kryetarit (në këtë rast duhet të plotësojë ndër të tjera dhe kriterin e 1 (një) viti eksperience).
3. Në ushtrimin e funksioneve të tij Senati ka kompetencat si më poshtë:
 - a) të marrë pjesë me të drejtë vote në të gjitha mbledhjet e “KSUMT”;
 - b) të përfaqësojë dhe të shpreh vullnetin e studentëve për çdo nevojë të tyre para “KSUMT”, stafit akademik dhe jo akademik të fakultetit, seksioneve, dekanit të studentëve si dhe dekanëve fakulteteve të “UMT”-së.

Neni 13

Përgjegjësi i Departamentit

1. Departamenti përbëhet nga përgjegjësi dhe anëtarë të tjerë të saj. Ajo është njësia që ekzekuton vendimet e “SS”.
2. Në varësi të interesave studentor, çdo departament ka një strukturë të tillë organizimi e cila përmes personelit të kualifikuar plotëson çdo nevojë studentore që lidhen me informacionin, trajtimin e problematikave të ndryshme studentore, karrierën, aktivitetet.
3. Kompetencat e përgjegjësive janë të mirëpërcaktuar në rregulloren e brendshme si dhe në Statut.

Neni 14

Shkarkimi i Bordit Ekzekutiv

1. Propozimi për shkarkimin e Kryetarit i drejtohet Dekanit të Studentëve dhe mund të bëhet nga:
 - a) 1/3 e të gjithë studentëve të universitetit;
 - b) 1/3 e të gjithë senatorëve.
2. Propozimi për shkarkimin e zv.kryetarit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Përgjegjësit të Departamentit mund bëhet nga 1/3 e të gjithë anëtarve të “SS” dhe/ose kryetari.

3. Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm shkarkohet vetëm me vendimin e 3/5 të të gjithë senatorëve të "KSUMT". Zv/kryetari shkarkohet vetëm me vendim të Kryetarit.
4. Vendimi për shkarkimin e kryetarit merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga senatorët. Ndërsa për Sekretarin e Përgjithshëm dhe Përgjegjës të Departamentit shkarkimi merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga anëtarët e "SS".

Neni 15

Shkarkimi i Senatorit

1. Propozimin për shkarkimin e senatorit mund të bëhet nga:
 - a) 1/5 e studentëve të zonës së tij elektorale;
 - b) 1/3 e të gjithë senatorëve.
2. Senatori mund të shkarkohet me votim të fshehtë të studentëve që përfaqëson me shumicë votash. Në të njëjtën mënyrë votimi rizgjidhet dhe senatori i ri nga studentët e të njëjtit vit dhe degë.
3. Senatori mund të shkarkohet me vendimin e 3/5 të të gjithë senatorëve studentore. Në këtë rast, vendimi për shkarkimin e senatorit merret pasi është kryer votimi i fshehtë nga senatorët studentore.

Neni 16

Humbja e Mandatit

1. Senatori e humbet mandatin kur:
 - a) kryen me shumë se pesë mungesa të pajustificuara në mbledhjet e "SS";
 - b) shkarkohet;
 - c) jep dorëheqjen;
 - d) merr tre vërejtje nga Kryetari për shkelje të etikës gjatë mbledhjeve të "SS" ose për veprimtari në kundërshtim me statutin dhe interesat e "KSUMT".

Neni 17

Të Drejtat dhe Detyrat e Studentëve në Marrëdhënie me "KSUMT"

1. Çdo student, pasi ka depozituar kërkesën me shkrim tek senatori i klasës dhe ky i fundit pasi ka marrë miratimin për të futur këtë çështje në rend dite, ka të drejtë të shfaqë mendimet e tij, të diskutojë në mbledhjet e "SS", të kërkojë llogari për manaxhimin e fondeve, etj.;
2. Çdo student ka të drejtë të informohet mbi veprimtarinë e "KSUMT";

3. Çdo student ka për detyrë që në marrëdhëniet me “KSUMT” të zbatojë me rigorozitet rregulloren e saj.

Neni 18

Mandatimi

1. Mandatimi i Senatorit kryhet nga Komisioni i Zgjedhjeve.
2. Mandatimi i Kryetarit të “KSUMT” kryhet nga Senati Studentor.

KREU III

PËRGATITJA DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 19

Këshilli Zgjedhor i “UMT”

Zgjedhjet për Senatin e Studentëve dhe Kryesinë e “KSUMT” mbikqyren dhe administrohen nga:

- a. Dekani i Studentëve;
- b. Përgjegjësi për administrimin e platformës Edu4School në “UMT”;
- c. Ish-Kryetari i Këshillit Studentor në rast se nuk rikandidon;
- d. Dy studentë nga “KS” paraardhës që zgjidhen nga ish-Kryetari i Këshillit Studentor që nuk rikandidojnë.

Neni 20

Zgjedhësit dhe Lista e Zgjedhësve

1. Kanë të drejtën e zgjedhjes dhe për tu zgjedhur të gjithë studentët e Universitetit “Metropolitan Tirana”, të cilët ndjekin studimet në një nga programet që ofrohen në Bachelor, Master, Programet e Integruara të Nivelit të Dytë (PIND) dhe Programet Profesionale.
2. Kanë të drejtë për të kandiduar për Kryetar të Këshillit Studentor studentët që përzgjidhen në Senatin Studentor me mesatare të ponderuar 8 (për studentët që përzgjidhen nga viti i parë llogaritet mesatarja nga gjimnazi). Në rast se asnjë nga kandidatët për Kryetar të Këshillit Studentor nuk e përmbush këtë kriter, atëherë ulet pragu i mesatres në 7.5.

Neni 21

Procedura Zgjedhore

1. Studentët të cilët duan të kandidojnë për “SS” dërgojnë, brenda afateve të njoftuara, kandidaturën e tyre në e-mailin e Këshillit të Zgjedhjeve pranë “KSUMT”.
2. Pas mbylljes së afatit për kandidim, Këshilli i Zgjedhjeve pranë “KSUMT” harton dhe publikon listën e kandidatëve.

3. Kjo listë ngarkohet nga përgjegjësi për platformën Edu4School, në mënyrë të tillë që studentët të mund të zgjedhin vetëm kandidatët e degës dhe vitit të tyre.
4. Studentët mund të zgjedhin vetëm një herë dhe vetëm një nga kandidatët.

Neni 22

Shpallja e Fituesve

Lista me emrat fitues të zgjedhur për të qenë anëtarë të “KSUMT” publikohet në Ëeb-in dhe rrjetet sociale të “UMT”, si dhe iu njoftohet përmes platformës Edu4School çdo student.

Neni 23

Dispozita Përfundimtare

1. Të gjitha palët duhet të sigurojnë zbatimin korrekt të kërkesave të mësipërme, të cilat janë pjesë e rregullores së brendshme të Universitetit “Metropolitan Tirana”.
2. Çdo ndryshim mbi këtë rregullore bëhet me propozim të 2/3 të anëtarëve të “SS” dhe miratohen vetëm me vendim të 3/5 të anëtarëve të saj, duke marrë dhe konsultimin e juristit të “UMT”-së.
3. Kjo rregullore e shtrinë veprimtarinë dhe funksionin e saj, duke filluar nga momenti i nënshkrimit nga Kryetari i Senatit Akademik të Universitetit “Metropolitan Tirana”.